

DUOS sh.p.k

duos
NIPT L51513008B

Forma juridike: Shoqëri me Pëgjegjesi të Kufizuar

Data e themelimit: 13.03.2015

Numri unik i indentifikimit (NIPT): L51513008 B

Adresa e Selise: BLV, Gjergj Fishta , P.Gora, Kulla3 Kati5, Ap24 Tiranë

Objekti tregtar: Shërbime të menaxhimit të projekteve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit . Shitje dhe dhenie me Qera Licence software. Shërbimeve dhe produkteve të lidhura me to. Shërbime të konsulentëve teknikë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe aktivitete të tjera të subjekteve private dhe publike ”

Pasqyrat Financiare 2016

(Mbyllur më 31.12.2016)

Pasqyra financiare: Individuale (jokonsoliduara)

Periudha kontabel: Nga 01.01.2016 deri më 31.12.2016

Data e mbylljes: 27 Mars 2017

Monedha: Leke

Shkalla e rrumbullakimit: në leke

Tiranë, Mars 2017

Tabela e përmbajtjes

A. RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR	0
B. BILANCI KONTABEL	2
C. PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	3
D. PASQYRA E FLUKSIT TE PARASE.....	4
E. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALET E VETA	5
F. SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE	6-11

duos

NIPT L51513008B

Edoan Guray

Pasqyra e Pozicionit Financiar(Bilanci)
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016

A	AKTIVET	Shënime	Viti raportues 31.12.2016	Viti paraardhës 31.12.2015
I	Aktive Afatshkurtera			
	Aktive monetare		10,452,536	41,257
	Te drejta te Arketueshme	3		
	Nga Aktiviteti I Shfrytezimit	3.1	275,100	4,920,000
	Te tjera	3.4	688,914	-
	Inventari	4		
	Lende te Pare dhe materiale qe Konsumohen	4.1		
	Mallra	4	-	-
	Totali i Aktiveve Afatshkurtera(I)		11,416,550	4,961,257
II	Aktive Afatgjata			
	Aktivet Materiale	8	-	-
	Toka e Ndertesa			
	Impiante dhe Makineri	8.1		-
	Te tjera instalime dhe pajisje		337,107	-
	Parapagime per aktive materiale dhe ne proces		-	-
	Totali i Aktiveve Afatgjata(II)			
	TOTALI I AKTIVEVE (I + II)		11,753,657	4,961,257
B	DETYRIMET DHE KAPITALI			
I	Detyrime Afatshkurtera	13		-
	Tituj e huamarjes			-
	Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	13.4	99,118	-
	Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve sh	13.8	27,900	95,775
	Te pagueshme per detyrimet tatimore	13.9	52,200	1,384,252
	Te pagueshme per shpenzime	14	804,125	300,000
	Totali i Detyrimeve Afatshkurtera (I)		983,343	1,780,027
II	Detyrime Afatgjata	17		-
	Titujt e Huamarjes	17.1		
	Detyrime ndaj institucioneve te kredise	17.2	-	-
	Te tjera te Pagueshme	17.8		-
	Grantet dhe të ardhurat e shtyra			
	Totali i Detyrimeve Afatgjata (II)			
	Totali i Detyrimeve (I+II)		-	-
III	Kapitali dhe Rezervat	22		
	Kapitali I nenshkruar	23		-
	Primi i lidhur me kapitalin	24	1,000	1,000
	Rezerva rivleresimi	25	-	-
	Rezerva të tjera	26		
	Rezerva ligjore	26.1	180,230	-
	Rezerva statutore	26.2		
	Rezerva te tjera	26.3		
	Fitimet(humbja) te pashpërndara	27	3,000,000	-
	Fitimi (humbja) e vitit financiar	28	7,589,085	3,180,230
	Totali i Kapitalit (III)		10,770,315	3,181,230
	TOTALI I DEYRIMEVE E KAPITALIT (I,II,III)		11,753,658	4,961,257

(Të gjitha balancat janë në lekë)

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërese e këtyre pasqyrave financiare

Pasqyra e Performances

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016

Përshkrimi i Elementëve	Shënime	Viti raportues 31.12.2016	Viti paraardhës 31.12.2015
Te Ardhura nga Aktiviteti I Shfrytezimit	29	11,479,390	4,100,000
Ndryshimi ne inventarin e produkteve dhe j	30	-	-
Puna e kryer nga njesia ekonomike dhe e k	31	-	-
Te Ardhura te tjera te shfrytezimit	32		
Lenda e pare dhe materiale te konsumuesi	33	85,446	9,580
1 Lenda e pare dhe e konsumueshme	33.1	85,446	9,580
2 Te tjera shpenzime	33.2		
Shpenzime personeli	34	1,125,483	280,529
1 Page dhe shperblime	34.1	964,424	240,385
2. shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetsc	34.2	161,059	40,144
Zhvleresimi I aktiveve afatgjata materiale	35.0	-	-
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	36.0	73,208	-
Shpenzime te tjera shfrytezimi	37.0	1,194,949	68,409
Totali i shpenzimeve (shuma 4 - 7)			
Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore	0	9,000,304	3,741,482
Zhvleresimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare te mbajtura si	39		
Shpenzime financiare	40		0
1. Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme	40.1		
2. Shpenzime te tjera financiare	40.2	71969	0
Pjesa e fitimit /humbjes nga pjesemarjet	41	-	-
Fitimi (humbja) para tatimit (9+/-13)	42	8,928,335	3,741,482
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin 69	43	1,339,250	561,252
1. Shpenzimi aktual I tatimit mbi fitimin	43.1		
2. shpenzimi I tatimit fitimit te shtyre	43.2		
3. Pjesa e tatimit fitimit te pjesemarjeve	43.3		
Fitimi (humbja) neto e vitit financiar (14-15)	44	7,589,085	3,180,230

(Të gjitha balancat janë në lekë)

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërese e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Fluksit te Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016
 (Të gjitha balancat janë në lekë)

Pasqyra e fluksit monetar – Metoda idnirekte	Shenime	Viti raportues 31.12.2016	Viti paraardhës 31.12.2015
Fluksi I Mjeteve Monetar nga(perdorur ne)veprimtaritë e shfrytëzimit			
Fitim/Humbja e vitit		8,928,335	3,741,482
Rregullime për shpenzimet jo monetare :			
Shpenzimet financiare jo monetare		-	-
Shpenzimet per tatimin mbi fitimin jomonetar		(1,339,250)	(561,252)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi		(73,208)	-
Zhvleresimi I aktiveve afatgjata materiale		-	-
Fluksi I mjeteve monetare perfshire ne aktivitet investuese :		-	-
Rritje/rënie në drejtat e arketueshme dhe te tjera		3,942,116	(4,920,000)
Rritje/rënie në tepricën inventarit		-	-
Rritje/rënie në tepricën e detyrimeve, për t'u paguar nga aktiviteti		(796,684)	1,780,027
Rritje/rënie në detyrime per punonjesit		-	-
Mjete monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit		10,661,309	40,257
Fluksi I Mjeteve Monetare nga (perdorur ne) aktivitetin e investimit		-	-
Para neto te perdorura per blerjen e filialeve		-	-
Arketime nga shitja e investimeve te tjera		-	-
Devidente te arketuar		-	-
Mjete monetare neto nga (perdorur ne) aktivitetin e investimit		(321,999)	-
Fluksi I Mjeteve Monetare nga (perdorur ne)aktivitetin e financimit			
Arketime nga emetimi I kapitalit aksionar		-	-
Arketime nga emetimi I aksioneve te perdorura si kolateral		-	1,000
Hua te Arketuara		-	-
Pagesa e kostove te trasaksionit qe lidhen me kredite dhe huate		-	-
Riblerje te aksioneve te veta		-	-
Pagesa e aksioneve te perdorura si kolateral		-	-
Pagesa e huave		-	-
Pagese e detyrimeve te qerese financiare		-	-
Interes I paguar		-	-
Devidente te paguar		-	-
Mjete monetare neto e përdorur në aktivitetet financiare		-	-
Rritja/rënia neto e mjeteve monetare dhe ekuivalentee te mjeteve mo		10,339,310	41,257
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël 1 Janar 2015		41,257	-
Efekti I luhatjeve te kursit te kembimit te mjeteve monetare		71,696	-
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël 31 dhjetor 2015		10,452,536	41,257

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërese e këtyre pasqyrave financiare

Pasqyra e ndryshimeve në kapital
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016
(Të gjitha balancat janë në lekë)

	Kapitali i regjistruar(aksi onar)	Primi i aksionit	Rezerva ligjore statusore	Fitimi pashpërndarë	Totali
Pozicioni më 31 Dhjetor 2015	1,000	-		3,000,000	3,000,000
Efekt ndryshimeve ne politikat kontabël	-	-	180,230	-	180,230
Pozicioni i rregulluar	1,000	-	-	3,000,000	3,180,230
Fitimi neto për periudhën kontabël				-	-
Dividentët e paguar				-	-
Rritje e rezervës së kapitalit	-	-		-	-
Emetimi i kuotave(aksioneve)	-	-		-	1,000
Pozicioni më 31 Dhjetor 2016	1,000	-	-	3,000,000	3,181,230
					-
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-			7,589,085
Dividentët e paguar	-	-			-
Emetim i kapitalit aksionar	-	-	-	-	-
Rritje e rezervës së kapitalit	-	-	-	-	-
Aksione te thesarit te riblera	-	-	-	-	-
					-
Pozicioni më 31 Dhjetor 2016	1,000	-	180,230	3,000,000	10,770,315

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërese e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacione te pergjitheshme

"DUOS " sh.p.k, eshte themeluar si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me 13 Mars 2015 dhe gjendet e regjistruar ne regjistrin tregtar(QKR), indentifikuar me NIPT-in L51513008B

Veprimtaria kryesore tregtare e shoqerise per ushtrimin 2016

Objekti i Veprimtarise eshte "Sherbime te menaxhimit te projekteve ne fushen e teknologjise se informacionit dhe komunikimit .Shitje dhe dhenie me Qera Licence software. Sherbimeve dhe produkteve te lidhura me to.Sherbime te konsulences teknike ne fushen e teknologjise se informacionit dhe aktivitete te tjera te subjekteve private dhe publike "

Kapitali i shoqerise i regjistruar ne QKR eshte 1000 LEKE.

Shoqeria DUOS shpk administrohet nga Z.Elidon Guna

Adresa e shoqerise eshte : Njesia Bashkiake nr:7 .Blv ,Gjergj Fishta ,Pallati Gora ,Kulla 3,Kati 5, Ap 24 Tirane.

2. Permbledhje e politikave kontabel

Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me ligjin shqiptar 'Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-te). Ato janë përgatitur mbi bazen e parimit të kostos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit të drejtave të kostatuara. Paraqitja e tyre është bërë në monedhën vendase, Lekë Shqiptar ("lekë).

Parimet kontabile më domethënëse që janë përdorur nga shoqëria, janë si më poshtë:**Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre**

Mjetet monetare përfshijnë mjetet monetare në arkë,banke dhe depozitat me afat. Ekuivalentët e mjeteve monetare janë investime afatshkurtra, shumë likuide dhe të gatshme për t'u konvertuar në shuma të njohura të mjeteve monetare dhe të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë.

Flukset monetare janë hyrjet ose daljet e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare.

Veprimtari të shfrytëzimit janë aktivitetet bazë të prodhimit të të ardhurave të njësisë ekonomike dhe aktivitete të tjera të cilat nuk janë aktivitete investuese ose financuese.

Veprimtari investuese janë blerja, dhe nxjerrja e aktiveve afatgjata dhe investime të tjera që nuk përfshihen në ekuivalentët e mjeteve monetare.

Aktivitete financuese janë aktivitetet që cojnë në ndryshime në masën dhe përbërjen e kapitalit neto të kontribuar dhe të dhe huamarrjeve afatgjata ose aftashkurtëra nga njesia ekonomike.

Overdraftet bankare konsiderohen si financim,si flukse nga veprimtaria financiare, dhe si rrjedhim përjashtohen nga Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare.

Paraqitja në bilancin kontabël korespondon me Mjetet monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare sipas përkufizimit të mësipërm.

Aktivet financiare

Shoqëria i klasifikon aktivet financiare në Llogari/Kërkesa të arkëtueshme nga klientët dhe në Llogari/Kërkesa të tjera të arkëtueshme. Menaxhimi vendos për klasifikimin në momentin e njohjes fillestare. Aktivet financiare paraqiten në bilanc me vlerën neto nga zhvlerësimi nëse ka.

Llogari/Kërkesa të arkëtueshme njihen si aktive atëherë kur njësi ekonomike bëhet palë e një kontrate dhe, si rrjedhim, ka një të drejtë ligjore për të marrë mjete monetare nga klientët e saj. Njohja fillestare e kërkesave për t'u arkëtuar nga klientët ndodh derisa mallrat ose shërbimet e porositura janë nisur për tek klienti, kanë mbërritur tek klienti ose shërbimi është kryer. Kërkesat për tu arkëtuar vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuar me koston e amortizuar (kosto fillestare minus arkëtimet e bëra, minus zhvlerësimet nga borxhi i keq nëse ka) pavarësisht nga qëllimi i njësisë për t'i mbajtur ato deri në maturim.

Transaksionet me monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit. Diferencat nga konvertimi, fitimet ose humbjet, regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në zërin "Të tjera të ardhura (shpenzime) financiare". Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kostos historike dhe nuk rivlerësohen.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2016 janë 1 euro=135.23 leke dhe nuk ka transaksion në monedhë të huaj tjetër.

Inventarët

Vlerësimi në hyrje i inventareve bëhet me cmimet e blerjes dhe në rastet kur është e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara për të sjellë inventarët në kushte magazinimi.

Gjendjet e Inventarit në pasqyrat financiare paraqiten me kostot e blerjeve të fundit të ushtrimit që nga drejtimi është cmuar se vlera neto të realizueshme.

Aktivet afatgjata materiale

Aktivet afatgjata materiale (AAM-të) bazohen në modelin e kostos. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Amortizimi per te gjitha grupet, llogaritet dhe njihet me metodën e vlerës së mbetur, me norma te cilat janë të përafërta me jetegjatesine mesatare te parashikuar te përdorimit. duke perdorur normat e percaktuara me Ligj per Mobilie e Orendi Zyre eshte llogaritur me 20% interes ne peridhat perkatese per Paisjet Informatike eshte perdorur nje interes 25 %..

Detyrimet afatshkurtra dhe afatgjata

Detyrimet shoqëria i klasifikon në afatshkurtra dhe afatgjata.

Huamarrjet afatshkurtër njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë kostot e transaksionit. Huat më pas vlerësohen me koston e amortizuar: çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas. Huat klasifikohen si detyrime afatshkurtra, me përjashtim te rastit kur shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabël.

Detyrimet afatshkurtra klasifikohen në Detyrime tregtare/Llogari të pagueshme ndaj furnitorëve dhe te detyrime të tjera. Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tregtare të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas në bilanc paraqiten të vlerësuara me koston e amortizuar.

Detyrimet ndaj shtetit për tatimet dhe për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore paraqiten me shumën e tyre te llogaritur sipas kërkesave ligjore në fuqi më datën e ndërtimit të pasqyrave financiare.

Huat afatgjata vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuar me koston e amortizuar. Çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlogaritet me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatat e ofruara.

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria zbaton parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtit ushtrim kontabel. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre, pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar ato.

Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi per tatimin mbi fitimin perfaqson shumen e tatimit per tu paguar per vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem per vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregetar qe raportohet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin per ushtrimin 2016 eshte 15 % aq sa ka qene ne ushtrimin e mëparshëm. Shoqëria nuk zbaton kërkesat e SKK-11 për tatimi e shtyrë.

3. Aktive monetare (likujditete në arke dhe bankë)

Gjendjet e mjetet monetare ne banke dhe arke, ne leke dhe valute, ne datat 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 jane si me poshte:

Emertimi i Llogarise	Monedha	Gjendja ne 31.12.2016		Gjendja ne 31.12.2015	
		Ne leke	Ne valute	Ne leke	Ne valute
Llogari bankare	LEK	10,249,394	0	387	-
Arka ne leke	LEK	203,142	0	40,870	-
Shuma		10,452,536	x	41,257	x

Gjendjet e llogarive te likujditeteve te paraqitura ne pasqyrat financiare jane te njejta me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike te monedhave. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, jane përkthyer ne leke duke përdorur kursin e këmbimit të fundit te ushtrimit te bankes respektive.

4. Aktive të tjera financiare afatshkurtra

Kerkesat e arketueshme dhe aktive te tjera financiare, ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2016 deklarohen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2016	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2015
Aktive të tjera financiare afatshkurtra		
(i) Llogari / Kërkesa të arkëtueshme	275,100	4,920,000
(ii) Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme Tatim Fitimi	0	0
Te tjera TVSH	0	0
Debitore e Kreditore te tjere	688,914	0
Shuma	964,014	4,920,000

Ne "Llogari / Kërkesa të arkëtueshme " jane pasqyruar shitjet e sherbimeve ndaj klienteve te pa likujduara ne fund te ushtrimitme 275.100 leke

Drejtimi mendon se te gjitha kerkesat do te arketohen ne nje periudhe afatshkurter me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikon renie ne vlere.

5. Inventari

Gjendjet e inventarit ne fillim dhe fund te ushtrimit nuk ka

- Shpenzime te shtyra nuk ka
- Te arketueshme nga te ardhurat e konstatuara nuk ka
- Aktive Biologjike nuk ka
- Aktive Tatimore te shtyra nuk ka
- Kapital i nenshkruar i papaguar nuk ka

6. Aktivët Afatgjata Materiale(AAM-te)

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve afatgjata materiale ne pasqyrat financiare paraqitet si vijon:

Gjendjet dhe levizjet	Toka	Ndertesa	Makineri dhe pajsje	Aktivët te tjera afatgjata materiale	Totali
A Kosto e AAM-ve me 01.01.2016	-	-	410,316	0	410,316
0 Shtesat	-	-	0	0	0
0 Pakesimet	-	-	0	0	0
0 Kosto e AAM-ve 31.12.2016	-	-	410,316	-	410,316
0	0	0	0	0	0
B Amortizimi AAM-ve 01.01.2016	-	-	0	0	0
0 Amortizimi ushtrimit	0	0	73,208	-	73,208
0 Amortizimi per daljet e AAM-ve	-	-	0	0	0
0 Amortizimi i AAM-ve 31.12.2016	-	-	73,208	-	73,208
0	-	-	0	0	0
C Zhvleresimi AAM-ve 01.01.2016	-	-	0	0	0
0 Shtesat	-	-	0	0	0
0 Pakesimet	-	-	0	0	0
0 Zhvleresimi AAM-ve 31.12.2016	-	-	-	-	-
0	0	0	0	0	0
D Vlera neto e AAM-ve 01.01.2016	0	0	0	0	0
0	-	-	0	0	0
0 Vlera neto e AAM-ve 31.12.2016	0	0	337,108	0	337,108

Vlerat dhe klasifikimi ne grupe i AAM-ve te pasqyruara ne bilanc dhe ne tabelen e mesiperme jane te perputhura me te dhenat e inventarizimeve fizike qe shoqeria e ka kryer ne fund te muajit dhjetor 2016.

Si politike kontabel per kontabilizimin dhe spjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e koston(SKK-5).Vleresimi fillestar ne momentin e marrjes ne inventar eshte bere me koston e marrjes dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi.

Drejtimi mendon se pergjithesisht per kete ushtrim kontabel, nuk ka shenja te renjes ne vlere te AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvleresime.

Metodat dhe normat e amortizimit të AAM-ve të përdorura janë njëta me ato që përdoren për qëllime fiskale. (shih shënimin nr.2) Masa e llogaritur e amortizimit si shpenzim nuk i tejkalon kufijtë e njohur për efektë fiskale.

7. Detyrime afatshkurtera-Huamarriet

Nuk ka

8. Detyrime afatshkurtera-Huate dhe parapagimet

Huate dhe parapagimet afatshkurtera në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabel 2016 paraqiten si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2016	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2015
Huatë dhe parapagimet		
(i) Të pagueshme ndaj furnitorëve	99,118	0
(ii) Të pagueshme ndaj punonjësve	27,900	95,775
(iii) Detyrimet tatimore	52,200	0
(iii) Detyrimet tatimore Tatim të tjera	804,125	1,384,252
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	0	300,000
Shuma	983,343	1,780,027

"Të pagueshme ndaj furnitorëve" pasqyron detyrimet ndaj furnitorëve për blerjen e mallrave e shërbimeve pa u likuiduar në fund të ushtrimit. Drejtimi mendon se të drejtat e furnitorëve janë të vlerësuara realisht.

"Të pagueshme ndaj punonjësve" përbehet nga detyrimi i papaguar ndaj personelit në 31.12.2016.

"Detyrimet tatimore+sig.shoqerore" përfaqësojnë detyrimin për :

- TVSH për Dhjetor 37.950 leke
- Sigurimet shoqerore e shëndetësore..... 27.900 leke
- Tatimi në Burim14.250 leke
- Tatim Fitimi 804.125 leke

9. Detyrime Afatgjata-Huate afatgjata

Të tjera të pagueshme janë detyrime që janë përdorur për rritjen e inventarit në shumën 31.055.388 leke

10. Kapitallet e veta

Kapitali i regjistruar i shoqërisë, i paraqitur në bilanc, është i njëjte me atë të përcaktuar në statutin e shoqërisë dhe vendimet e depozituara në QKR. Me 31.12.2016 .Ai është 1000 leke, i ndarë 2 kuota me vlerë nominale 500 leke /kuota. Të zotëruara si më poshtë :

- Ilia Kotherja 50 %
- Bledar Sema 50%

Gjate ushtrimit kontabel 2016 nuk ka rritje ose paksim në kapitalin e regjistruar të shoqërisë dhe në raportet e zotërimit nga ortakët.

11. Fitimi (humbja) e vitit financiar

Pasqyra e të Ardhurave dhe shpenzimeve

- Të ardhurat

Të ardhura të realizuara gjatë ushtrimit, sipas segmenteve(kategorive) të biznesit paraqitet si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2016	Ushtrimi i mbyllur Dhjetor 2015	31
Te ardhurat			
Te ardhurat nga shitja e produkteve	0		0
Te ardhurat nga kryerja e sherbimeve	11,479,390	4,100,000	
Te ardhurat nga shitja	0		0
Te ardhurat te tjera(AAM)			0
Shuma	11,479,390	4,100,000	

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe sherbimeve jane vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara, te zhveshura nga TVSH-ja. Paraqitja ne pasqyrat financiare e te ardhurave dhe shpenzimeve eshte bere sipas natyres se tyre.

▪ Shpenzimet e veprimtarise kryesore

Konsumi i materialeve, mallrave, furniturave, punimeve e sherbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane rregjistruar me shumate e paguara ose te pagueshme. Kostoja e punesimit, page dhe sigurime shoqerore, eshte pasqyruar saktesisht si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar. Taksat lokale e taksa e tatime te tjera qe lidhen me biznesin jane llogaritur dhe pasqyruar ne llogarite e ushtrimit. Sipas natyres se tyre shpenzimet e ushtrimit 2016 jane treguar ne pasqyren perkatese.

Ne zerin "Shpenzime te tjera" pasqyruar ne piken 7 te Pasqyres se te Ardhurave dhe Shpenzimeve analizohen si vijon

	Viti raportues 31.12.2016	Viti paraardhës 31.12.2015
Materiale te Konsumuara	85,446	
Shpenzime paga	1,125,483	280,529
Furnitura, nentrajtime dhe sherbime	365,719	9,580
Qera	645,000	42,500
Telefoni, internet	48,601	-
Sherbime nenkontraktore	61,333	21,223
Te tjera sherbime	67,000	4,686
Shpenzime Bankare	7,296	
Amortizimi	73,208	-
Shpenzime te tjera rrjedhese	-	-
	2,479,086	358,518

▪ Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Jane paraqitur si diference e te ardhurave me shpenzimet sipas kerkesave te standarteve. Shumat e tyre nuk jane materiale.

12. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatimi mbi fitimin per ushtrimin kontabel 2016 dhe 2015 jane si vijon:

	Viti raportues 31.12.2016	Viti paraardhës 31.12.2015
I FITIMI NETO PARA TATIMIT	8,928,335	3,741,482
II SHPENZIME TE PAZBRITESHME (+)	-	(200)
1 Amortizime tej normave fiskale	-	-
2 Shpezime pritje e dhurime tej kufirit tatimor	-	-
3 Gjoha,penalitete,demshperblime	-	-
4 Provizione qe nuk njihen	-	(200)
5 Shpenzime pa dok. ose jo te rregullta	-	-
6 Te tjera	-	-
III PJESA E HUMBJES SE MBARTUR(-)	-	-
IV FITIMI (HUMBJA) TATIMORE(I+II-III)	8,928,335	3,741,682
V Shpenzimi i tatim fitimit-15%	1,339,250	561,252
VI FITIMI NETO I USHTRIMIT(I-V)	7,589,085	3,180,430

Tatim fitimi i ushtrimit eshte i llogaritur mbi fitimin e tatueshem, i cili eshte rregulluar nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal, analizuar ne tabelen e mesiperme.

13. Transaksione te paleve te lidhura

Ne marrjen ne konsiderate te çdo transaksione dhe marredhenie te mundeshme, jo thjesht formen ligjore te tyre , ne 31 dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 nuk ka transaksione me palet e lidhura.

14. Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit

Asnje ngjarje e rendesishme nuk ka ndodhur pas dates se miratimit te pasqyrave financiare.

15. Shifrat krahasuese

Shifrat krahasuese te deklaruar ne pasqyrat financiare 2015 jane te njejta me ato te prezantuara ne vitin aktual 2016.

Administrator

Elidon Guna

Elidon Guna

duos
NIPT L51513008B